

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve B. B. dhe V. B., të dy nga Prishtina, të cilët i përfaqëson M. H., av. nga Prishtina, kundër të paditurit M. G. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson Q. Q., av. nga Prishtina, për dorëzimin në posedim ose dëmshpërblim, përkitazi me revizionin e paditësve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3092/2013, datë 4.11.2015, në seancën e mbajtur më 16.3.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3092/2013, datë 4.11.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3092/2013 datë 4.11.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, C.nr.291/2012, datë 18.3.2013, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është refuzuar në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve që të konstatohet se i padituri ka bërë uzurpimin e të drejtës së banimit për mbindërtim, në objektin ... në lagjen "...", me sipërfaqe prej 115,15 m² dhe të detyrohet i padituri që ta bëjë kthimin në gjendjen e mëparshme, si dhe të detyrohet që paditësve t'ua kthejë në posedim tarracën në ndërtesën ..., H.I ose t'ua paguajë si kundërshpërblim shumën prej 35.840 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e me kërcënim të përmbarimit me dhunë. Me pjesën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësit me kohë kanë paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që revizioni të aprovohet si i bazuar, ndërsa aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi si e bazuar, ose ato të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësve, me vendimin e Sekretariatit për Urbanizëm, Ndërtimtari dhe Mbrojtje të Ambientit të Komunës së Prishtinës, u është dhënë leja urbanistike nr. ... datë ..., lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm i Komunës së Prishtinës, për mbindërtimin e banesës në objektin ... në lagjen "...", me sipërfaqe prej 115.15 m². Me pikën 5 të vendimit të përmendur është përcaktuar se leja për mbindërtim pushon të vlejë, nëse punët e mbindërtimit nuk përfundojnë në kohën prej një viti nga dita që vendimi të ketë marrë formë të prerë. Paditësit, për shkak të rrethanave të luftës, janë shpërngulur nga Kosova dhe nuk e kanë ndërtuar objektin sipas lejes së ndërtimit. I padituri, pas luftës në Kosovë, ka ndërtuar objektin–mbindërtimin e banesës në vendin e cekur, ndërsa dokumentacioni i prezantuar në gjykatë ka qenë i panënshkruar dhe i pavulosur.

Paditësit me padi kanë kërkuar të detyrohet i padituri ta bëjë kthimin në gjendjen e mëparshme, t'ua kthejë në posedim atyre tarracën ose, si kundërshtëpërbllim, t'u paguajë shumën prej 35.840 €.

Gjykata e shkallës së parë, në bazë të kësaj gjendjeje të vërtetuar faktike, ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësve është e pabazuar, sepse leja e ndërtimit nuk paraqet bazë juridike për mbrojtje të pronës, qoftë kjo edhe si mbrojtje e posedimit të sendit, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, e ka vlerësuar si të ligjshëm dhe të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, të shprehur në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, pasi që, në bazë të analizimit dhe vlerësimit të provave, gjykata e shkallës së parë, drejt dhe plotësisht e ka vërtetuar gjendjen faktike sipas barrës së të provuarit dhe e ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadija e paditësve kundër të paditurit në këtë rast nuk bazohet në ndonjë titull të vlefshëm juridik për fitimin e të drejtës së pronësisë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata shkallës së dytë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve dhe kur e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për çka ka dhënë arsye, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara thëniet e paditësve të parashtruara në revizion, sipas të cilave aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë marrë me shkelje thelbësore të parashikuara nga neni 214 par. 1 pika (b) dhe (c) të LPK, ngase neni i përmendur ka të bëjë me shkaqet për të cilat mund të paraqitet revizioni, ndërsa pretendimi se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e dhëna në aktgjykim, nga kjo Gjykatë u vlerësua si i pabazuar, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në harmoni me arsyetimin dhe me provat e administruara në shqyrtimin kryesor.

Pretendimin e paditësve se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë e precizuar të paditësve, por ka gjykuar mbi një çështje që nuk është paraqitur në procedurën kontestimore, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase, sipas precizimit të kërkesëpadi në seancën e datës 18.3.2013, paditësit kanë kërkuar që i padituri t'ua dorëzojë në posedim tarracën ose t'ua kompensojë dëmin në kundërvlerë prej 35.840 €, ndërsa gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë e të ligjshme kanë vlerësuar se kërkesëpadi e paditësit është e pabazuar, sepse, sipas nenit 37 par. 1 të LTHMPJ, vetëm pronari mund të kërkojë kthimin e sendit nga mbajtësi i tij. Kjo Gjykatë shton se paditësit nuk kanë plotësuar asnjë kriter të parashikuar nga dispozita e nenit 20 par. 1 të LTHMPJ për fitimin e të drejtës së pronësisë, ndërsa gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë se leja e ndërtimit nuk paraqet bazë juridike për mbrojtje të pronës.

Është i pabazuar pretendimi i paditësve, i ngritur në revizion, se gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë dhënë fare arsye për kompensimin e dëmit në kundërvlerë prej 35.840 €, sepse në aktgjykimet e tyre janë arsyetuar faktet se me vetë përfundimin e të drejtës së ndërtimit, në këtë rast paditësit nuk kanë të drejtën e kompensimit të dëmit të pretenduar në kërkesëpadi, sepse, nuk përmbushen kërkesat ligjore të LMD, që kanë të bëjnë me dëmin pasuror.

Pretendimin e paditësve se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk përmban fare arsye për pretendimet ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë dhënë arsye të mjaftueshme për një gjykim të drejtë e të bazuar në ligj.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk e shqyrtoi pretendimin lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike, ngase sipas nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit të plotë e të gabuar të gjendjes faktike.

Nga sa u tha më lart e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Rev.nr.58/2016, datë 16.3.2016

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku